

RAPORT TEKNIK

REHABILITIMI I KANALIT VADITES NE NJESIN ADMINISTRATIVE ZERQAN , BASHKIA BULQIZE

Procurement
Albania

PERMBAJTJA E RELACIONIT

1. - Hyrje
2. - Te dhenat e Detyres se Projektimit
3. - Qellimi i Detyres se Projektimit
4. - Dokumentacioni i nevojshem per t'u paraqitur
5. - Hidrogjeologjia, Gjeologjia dhe Topografia
6. - Zgjidhja Teknike e Projektit
 - 6.-1. Pershkrimi i Nderhyrjes
 - 6.-2. Llogaritjet hidraulike
 - 6.-3. Paraqitja ne menyre tabelare
 - 6.-4. Horografia e objektit
7. - Azhornimi me infrastrukturen ekzistuese.
8. -Mbi organizimin e punimeve.
 - 8.-1. Organizimi i punimeve
 - 8.-2. Preventivi i punimeve
9. -Mbi afatet e kryerjes se punimeve.
- 10.- Manuali i instruksioneve dhe rekomandimeve te mirembajtjes.
11. - Ilustrimi me foto i gjendjes ekzistuese

1.- Hyrje

Rehabilitimi i kanalit vadites Kozjak -Valikardhe Njesia Administrative Zerqan do te sherbej per vaditjen e 120 ha toke bujqesore ne tre Fshatin Valikardhe , ne Njesine Administrative Zerqan , te Bashkise Bulqize, keto toka jane nder me te mirat e Pellgut te Lumit Bulqize . Ketu kultivohen te gjitha llojet e Prodhimeve Bujqesore si : Gruri , misri sit e gjitha llojet e Perimeve e bimeve faragjere si dhe te Pemeve Frutore , e cila ndodhen 9 km ne Verilindje te Bashkise Bulqize (te qytetit te Bulqize). Keto fshatra ndodhen ne terren kodrinor-malor ne lartesi 500 deri ne 600 m mbi nivelin e detit, me klime te tipit mesdhetare-kontinentale malore, me dimer te ftohte e te lagesht dhe vere te nxehte e te thate.

Kanali ujites ekzistues eshte ndertuar ne vitet 1940 dhe aktualisht eshte pothuajse i amortizuar dhe nuk funksionon ne te gjithe gjatesine e tij prej afro 2600 ml.

Rehabilitimi i tij ploteson nevojat per vaditje te tre lagjeve te fshatit Valikardhe ; duke vene nen uje afro 100 ha.

Burimi kryesor perroi I Kozjakes eshte 100 l/sek dhe Burimet i ujit i projektuar garanton nje sasi uji rreth 10 deri 30 litra/sekonde ne periudha piku dhe prurje mesatare rreth 120 deri 150 litra/sekonde, kjo dhe nga historiku e te dhenat e grumbulluara gjate periudhes se shfrytezimit,. Me ketë sasi uji, po të rehabilitohet kanali vadites garantohej edhe ujitja e mjaftueshme e tokës së kultivuar.

Vepra e Marjes eshte me mjet Primitive dhe kanali gjate gjithe Gjatesise se tij eshte I pa veshur , ku humbjet jane te konsiderueshme . Kalimi Kete objekt e ka ne zoterim Shoqata e Perdoriesve te Ujit, e cila eshte te interesuar per venien ne eficence te plote te tij.

2.- Te dhenat e detyres se projektimit

Detyra e projektimit eshte hartuar nga Bashkia Bulqize

Kjo detyre kerkon te hartohet i detajuar projekti i zbatimit per Rehabilitimin e kanalit te vaditjes ne fshatrat Kovashice, Homezh , Boceve dhe Shupenze (Njesia Administrative Shupenze,) Bashkia Bulqize; duke patur parasysh sa me poshte:

1. Siperfaqja e tokave bujqesore qe kerkohet te ujitet eshte 100 ha
2. Te ndertohet rrjeti i kanaleve dhe tubacioneve shperndares per te ujitur te gjithe siparfaqen e parashikuar prej 100ha.
3. Per projektimin e tubacioneve te parashikohen perdorimi i tubacioneve prej celiku.
4. Te kihet parasysh qe kanali te mos devijoj nga gjurma e kanalit ekzistues.
5. Te zevendesohen te gjitha pjeset me tub metalik te amortizuara, me tuba te rinj.
6. Te sistemohen te gjitha degezimet dalese per ne kanalet dytesore (prizat).
7. Vlera e objektit te percaktohet sipas preventivit te hartuar per kete qellim.

3.-Qellimi i Detyres se projektimit

Detyra e konsulentit projektues eshte te realizohet projekti i rehabilitimit te kanalit dhe te garantohet percjellja e sasise se duhur per ujitje.

Te garantohet qendrueshmëria e kanalit ne te gjithe gjatesine e tij dhe te krijohen kushte per mirembajtjen e vazhdueshme te tij.

Te realizohet gjate sezonit te ujitjes nje shperndarje sa me komode e ujit per vaditjen e tokave te fermereve.

Uji per vaditje te jete I paster dhe te mos permbaje elemente te demshem per kulturat bujqesore.

Nje pjese e Kanalit do te merret me Sifon .

4.-Dokumentacioni i nevojshem per paraqitje

Detyra e projektimit e siperpermenduri kerkon pergatitjen e projekt-zbatimit me dokumentat si në vijim:

1. Shkrese percjellese e subjektit qe ka hartuar projektin ku i bashkelidhet inventari (permbajtja) e projekt-zbatimit.

2. Relacioni Teknik.

Pershkrimi me fjale i te dhenave baze, si dhe llogaritjet dhe rrezultatet e te dhenave projektuese, projektuesi duhet te parashikojë mundesisht dhe nje afat perfundimi punimesh optimal, tabele per makinerite qe mund te perdoren me specifikimet perkatese, punimet qe do te kryhen me krahe, parashikimi per transportin e materialeve, rruget e hyrjes ne objekt, etj.

3. Specifikimet Teknike.

Per punimet civile qe do te zbatohen sipas zerave te punes konform KTP dhe KTZ shqiptare, Standarteve te huaja te specifikuara.

4. Preventivi.

Te jete i qarte, i lexueshem dhe te perfshije te gjithe zerat e punes te parashikuar ne projekt-zbatim.

5. Vizatimet.

Menyra e parqitjes te jete e qarte, e lexueshme konform rregullave te vizatimit teknik. Ne to te perfshihen hollesi dhe detaje te nevojshme si dhe tabelat per volumet e punes.

6. Identiteti i Projektuesit.

Licensat personale te stafit projektues dhe te kompanise duhet te dorezohen te noterizuara.

7. I gjithe Projekt-Zbatimi duhet te jete i firmosur dhe i vulosur dhe duhet te dergohet me CD.



5.- Hidrogeologjia, Gjeologjia dhe Topografia

Prurjet maksimale ne vepren e marrjes te kanalit ujites shkaktohen kryesisht nga ardhjet e Perroit te Kozjakes .

Rreth 3 km mbi vepren e Marrjes te kanalit ujites, ne dretim te perroit , ndodhet Liqeni i Zi dhe Liqeni i Bardhe i nderuar ne pllaje me siperfaqe 165 ha . gjithashtu pjesa e perroit mbi rezervuar sherben edhe si ushqyes i ketij rezervuari . Baseni ujembledhes i vepres se marrjes kanalit mbi rezervuar perben 90 % te pellgut ujembledhes.

Ne kushtet e mesiperme ku pllaja dhe rezervuari luajne rol ne rregullimin e plotes per prurjen max eshte perdorur metoda e prerjes se plotes. Si stacion meteorologjik eshte mare stacioni i shupenzes dhe siguria e reshjeve eshte pranuar 25% duke patur parasysh se permbytja e saj nuk sjell pasoja ne toka bujqesore apo objekte te tjera te rendesishme .

Rezultatet e llogaritjeve sipas metodës së mesiperme jepen si më poshtë :
KOHA E ARDHJES KULMIT TE PLOTES

K1	V max	V m.s	L km	tn ore
3.6	2	1.4	7.5	1.5

Koha për të cilën merret shpejtë e shiut

tn ore	$(1+tn)^{0.2}$	T ore
1.5	0.85	1.2

Sasitë e reshjeve me siguri 20 % në mm për kohën tn (1.2 ore)

Sig %	H 24 orësh	N	A	Ht
20	70	0.317	25.6	29

Koeficienti i sheshimit të plotës

$\delta 2 = 1-0.35lg (1+0.1* fp)$	$\delta 2= 0.79$
------------------------------------	------------------

Prurja max me siguri 20 %

K1	H mm	K rr	F km ²	tn. Ore	Q m ³ /sek
0.28	29	0.55	15	1.5	36

Llogaritjet e mesiperme hidrologjike japin rreshjet maksimale të pellgut ujembledhese .

Pellgu ujembledhese është formacion gelqerore me karst të zhvilluar. Në formacionet të tilla filtrimet e ujit nga sipërfaqja në thellsi të shkëmbit janë dukuri të përgjithshme që krijohen dhe rezervuar të nëndheshme të cilat kryejnë rregullim natyror të rrjedhës.

Keto burime dalin në tokë në kuotën 1100-1200 m në N D.

Për ujëtimin e tokave bujqësore përdoret vetëm burimet e Perroit për këtë kanal .

Vete perperja gjeologjike e basenit ujembledhese si dhe burimet natyrale bejne rafshim ideal te plotes. Prurjet max. Te Plotes ne Vepren e marrjes shkojne 6.-8 m³/sek .

Prurjet minimale.

Prurjet minimale jane ne muajin gusht-shtator dhe variojne 4-5 m³/sek.

Per basnin siperfaqeasore prej 25 km² qe shkakton ne Vepren e Marjes te kanalit ujitesse per te cilit na interesojne prurjet minimale vlere e tyre eshte 100 litra/sek

Duke patur parasysh qe ne VM do te meren edhe ujrat e burimit te lekes te cilat sipas vrojtimeve verbale qe kemi bere pas vitit 1993 ne periudhat e thata e vitit per te gjithë konsumatoret qe marin uje nga ky burim per nevoja te ndyshme eshte pranuar $Q_{min.} = 120 \text{ l/sek}$

Gjeologjia:

Konkluzione dhe rekomandime

1. Vepra e Marjes do te vendoset mbi depozitimet flishoideale ne nje zone ku kemi dalje argjileve te murme ne siperfaqe. Kjo veper nuk paraqet problem gjelogo-inxhinjerike. Kryesisht traseja e kanalit kalon ne nje zone te qendrueshme . Kanali ka nje gjatesi 2518 ml.
2. Seksioni i pare i kanalit me nje gjatesi prej 260 ml vendosen mbi depozitimet deluviale-eluviale me nje trashesi qe luhetet nga 0.5 m deri 1.5 m dhe perbehet nga suargjila te mesme dhe te renda me ngjyre kafe te kuqerremte. Keto suargjila kane si matrial mbushes copra gelqerori. Nen keto depozitime vendosen depozitimet e triasikut te siper-Jurasikut te poshtem (T3-J1), te perbere nga gelqerore shtrese trashe deri masive.
3. Segmenti i dyte i trasese se kanalit vendoset ne nje zone te qete mbi depozitimet deluviale-eluviale me nje trashesi qe luhetet nga 0.4 deri 1.6 m dhe perbehet nga suargjila te mesme dhe te renda me ngjyre kafe te kuqerremte . Keto suargjila kane si matrial mbushes copra gelqerori. Nen keto depozitime vendosen depozitimet e triasikut te siper-Jurasikut te te siper (J 31-Cr2m), te perbere nga ndrthyrje flishoideale, ranoro-mergalore e nderfutje shtresash gelqeroresh. Ky segment nuk ka fenomene negative gjeologo-inxhinjerike. ketu do te ndertohet nje sifon prej 1600 ml
4. Ne nje seksion te shkurter traseja e kanalit kalon mbi depozitimet e perziera te kuaternarit (Qp-h) te perfaqesuara nga depozitime aluviale-proluviale, te perbera nga rera , zhavore dhe alevrite. edhe ketu pjesa fundore do te

ndertohet me kanal te veshur prej 680 ml ku do te ndahet ne dy pjese ne krye te fshatit qe do te sherbeje per ujitjen e tokave te gjithe fshatit

6.- Zgjidhja Teknike e Projekt Zbatimit

Kanali Kozjakes sherben per ujitjen e tokave bujqesore te fshatit te mesiperme me nje siperfaqe rreth 120 ha dhe kryen nje sherbim jetesore per kete komunitet .

Kanali ne keto kushte punon punon ne gjendje te degraduar dhe po shkon drejt abandonimit te plote .humbjet ne kanal jane teper te medha pasi uji kalon direct ne toke natyrore , pa veshje.

Vepra ka qene e ndertuar ne shpatin e malit ne krahun e djathte te perroit te Kozjakes dhe detyrimisht ka sherbyer edhe si kanal te ujrave te larta . ne kete menyre ne kanal cdo vit nga shpati anesor bie sasira te medha aluvionesh te cilat gjate pastrimit te kanalit kane cuar ne ngritje te konsiderueshme te bankinave ne anen e poshtme te tij duke veshtiresuar se tepermi funksionanimin normal te rrjedhes se ujit.

Perenjt qe zbresin nga shati I malit pergjithesisht shkarkohen direct ne kanal duke bere mbushjen massive si dhe carje te kanalit ne shume vende.

Marja e ujit ne parcela behet ne menyre primitive me carje direkte te bankines se kanalit duke e demtuar ate ne shume vende.

Gjithashtu kalimi I mjeteve , banoreve e bagetive nga njera ane e kanalit ne tjetren behet me kalim direct neper kanal duke e demtuar seriozisht.

Nga ana e komunitetit jane kryer disa nderhyrje te vogla por keto punime nuk jane bere sipas nje projekti perfundimtar dhe kane shume pak efektivitet.

Rikonstruksioni do te kryet nepermjet veshjes se kanalit me beton ne gjithe gjatesinee tij , dhenies se nivelacionit te nevojshem ne taban te kanalit dhe ne keto bankina nepermjet germimeve si dhe pajisjes se tij me vepra arti si veper marrje, shkarkuesa, prize marrje uji, ura kalimi, mbikalime perenjesh etj.

Vepra e Marrjes.

Ndertoht ne kuotat 1200 m ne koke te kaperderdhesit dhe 1198.5 m ne taban te marrjes se ujit, ne shtratin e perroit te Kozjakes .

Aktualisht uji ne perroin kalohet me anen e nje muri te thjeshte betoni I cili eshte shkateruar plotesisht pasi nuk eshte ne gjendje te perballoje prurjet maksimale.

Vepra e Marrjes qe do te ndertoht do te jete e tipit kaperderdhes me forme te regullt hidraulike dhe ne pjesen fundore te tij do te vendosen blloqe me tel gabion per te penguar me shume gerryerjet ne shtratin e perroit.

Pas sezionit te vaditjes duhet te hapet shkarkuesi I vepres se marrjes si dhe vrima e daljes se ujit nga pjesa kaperdedhese per ne kanal te bllokohet me mjet rrethanore me qellim qe plotat te kolojne direkte ne perrua. Detaje te hollesishme jepen ne vizatimin perkatese per vepren e marrjes.

Kanali.

Ujitja e siperfaqes do te behet me rrjedhje te lire, ose sic quhet ndryshe me permbytje. Per te bere te mundur shperndarjen e ujit projekti ka menduar te perdore seksionin trapezoidal. Kjo zgjedhje eshte bere per keto arsye:

1- Duke patur parasysh terrenin ku do te kalojne keto kanale qe jane toka te mbjella me kultura bujqesore.

Sistemi i kanaleve ekzistuese shperndarese eshte trapezoidale, keshtu qe eshte me ekonomike perdorimi i tyre.

2 - Meqenese pjerresite e nje pjese te kanaleve jane te vogla seksioni i propozuar eshte shume me i qendrueshem dhe trashesia e pareteve eshte propozuar 15 cm.

3 - Projekti propozoi ndertimin e ketij rrjeti kanalesh me seksionin e mesiperm duke perdorur beton format dhe vibratorin.

6.1 – Pershkrimi i nderhyrjes

Projekti i rrjetit shperndares te kanalit te Kozjakes do te ujite 120 ha . duke pranuar hidromodulin e ujitjes $q=1$ l/sek ha te nevojshem e ujit per vaditjen e tokave bujqesore qe mbulon ky kanal duhet te jete

$$Q= 100 \text{ l/s dhe } Q_{ll}=120 \text{ l/sek}$$

Sipas detyres se Projektimit kanali do te dimensionohet per 120 l/sek uje.

Ne dimensionimin e kanalit , pervecse percjellshmerise te prurjes qe sigurojne burrimet ne veper te marrjes duhen marre parasysh edhe permasat konstruktive funksionale te objektit.

Ne permasat konstruktive kuptohen :

- Gjeresia ne fund te kanalit te jete e atille qe punetori te kete mundesine e manovrimit per pastrim aluvionesh.
- Duke qene se eshte parashikuar veshje e thjetshte betony, per dheu pa nenshtesa pjerresia e skarpatave eshte parashikuar e tille qe tju rezistojte fenomene mekanike te levizjes dherave, ose e thene ndryshe , eshte pranuar $m=1$
- Lartesia e kanalit eshte pershtatur me veprat tip qe do te vendosen ne te , te cilat kane lartsi te caktuar.
- Permasimi konstruktiv I kanalit eshte paraqitur ne vizatimiet gafike ne fleten tip se bashku me elementet hidraulik te domosdoshme.

- Nga permasimi I paraqitur rezulton se sasia e ujit qe percjell ky kanal eshte me e madhe se ajo e dhene ne detyren e projektimit, por nga harmonizimi I dimensionit hidraulik me ate konstruktiv plotesohen edhe disa elemnt funksional te nevojshme dhe te kerkuar nga komuniteti si :
 - Sasia e ujit qe percjell kanali eshte afersisht e barabarte me sasine e nevojshme te ujit qe kerkohet per vaditjen e tokave bujqesore qe mbulon ky kanal, sipas kerkesave te bimeve bujqesore per hidromodul $q= 1 \text{ l/sek}$ ose $Q= 100 \text{ /sek}$. Eshte patur parasysh fakti qe tokat qe mbulon ky rrjet jane ujitur historikisht nga ky kanal.

parashikon rehabilitimin e rrjetit ekzistues dhe ndjek gjurmën ekzistuese të kalimit. Veprat e artit janë parashikuar të ndërtohen në pozicionin që kanë aktualisht, pasi të jenë prishur strukturat e betonit dhe të çelikut të veprave ekzistuese te cilat rezultojne te demtuara.

Në kanalin kryesor me gjatësi totale $L= 2518 \text{ ml}$ do të ndërhyhet tek:

6.2 – Llogaritjet hidraulike

Llogaritja e kanalit te hapur

- Shtreterit e hapur mund te jene natyrore si lumenjte e perrenjte ose artificiale si kanalet, tunelet, tubacionet pa presion, etj. Qe levizja e ujit ne

shtreterit e hapur (kanali i hapur ne rastin tone) te jete e njetrajtshme eshte e domosdoshme te plotesohen keto kushte gjeometrike dhe hidraulike:

- Kanali duhet te jete drejtvizore, me seksion te njejte ne cdo prerje dhe te kete ashpersi te njejte te siperfaqes.
- Thellesia e ujit ne kanal duhet te jete e njejte gjate gjithe gjatesise se tij.
- Prurja e ujit duhet te jete e pandryshueshme dhe si rrjedhim, e tille duhet te jete dhe shpejtesia e tij.

➤ Percaktuesit kryesore te nje shtrati ne forme trapezoidale, katerkendesh

kendrejte, etj jane: Q, V, i, m, n, H, b , ku:

Q : prurja [liter/sek]

V : shpejtesia e lengut [m/sek]

i : pjerresia e kanalit [m/m]

m : koeficienti i pjerresise se skarpateve [m/m]

n : koeficienti i ashpersise se veshjes

H : lartesia e kanalit [m]

b : baza e kanalit [m]

Nder te tjera kemi dhe:

S : siperfaqja e seksionit terthor te kanalit [m²]

C : koeficienti Shezi

R : rrezja hidraulike [m]

H_u : lartesia e ujit [m]

H_v : lartesia e veshjes me beton [m]

k: karkateristikat e prurjes

➤ Duke qene se kanali qe do te llogaritet eshte kanal egzistues dhe kemi te njohur prurjen (Q), pjerresia e kanalit (i), mund te kontrollojme lartesine e veshjes me beton (Hv) dhe shpejtesine e lengur (V). Per kete llogaritje na vjen ne ndihme tabelat perkatese:

- $k = Q \cdot \frac{1}{\sqrt{i}}$, $n = 0.020$ qe e kemi konstante per veshjet me beton.
- Duke pasur dhe gjeresine e kanalit (b), me anen e karakteristikes se prurjes (k), gjejme lartesine e ujit (Hu).
- Pas gjetjes se lartesis se ujit (Hu) dhe lartesis rezerve te kanalit (ΔH) qe varjon nga (10÷20)cm, kontrollojme veshjen e betonit nese e kemi brenda normave dhe vizatimeve te llogaritura me pare.
- Vijoje me percaktimin e shpejtesise (V):
 - $v = \frac{Q}{S}$ ku $S = \frac{b_M + B_V}{2} \cdot H_U$ per seksionet trapezoidal
 - $S = b \cdot H_U$ per seksion kendrejte

Llogaritja e sifonit

➤ Sifonet perdoren per te kaluar prurjen e kanalit vadites nen rruget automobilistike, hekurudhore, perrrenjte, lumenjte, etj. Sifonet mund te ndertohen ne tuba betoni, celiku, polietileni, gize, etj dhe mund te kene seksion rrethor, katror, katerkendesh, parabolik, etj. Pjeset kryesore te

sifonit jane vepra e hyrjes, pjesa qendrore dhe vepra e daljes.

- Sifonet me tub celiku perdoren ku ka depresione te medha gjate trasese se kanalit dhe ndertohen ne nderprerjet me perrenjte ose kur terreni eshte shume i aksidentuar. Per vende me temperatura minimale nen zero grade thellesia e vendosjes ne toke e kreut te tubit duhet te jete (1.4÷1.5)m por gjithmone 0.4m nen thellesine e ngrirjes. Per vende me temperature minimale mbi zero grade, thellesia e vendosjes se tubit duhet te jete 1m.
- Kanali per vendosjen e tubave ne toke duhet te ndertohet sipas llojit te tokes dhe ujrave nentokesore:
 - Per tuba me diameter (100÷200)mm (0.6÷0.7)m
 - Per tuba me diameter (250÷350)mm 0.9m
 - Per tuba me diameter (400÷500)mm 1.1m
- Kur formacioni eshte shkembore nen tub duhet hidhet nje shtrese dheu me trashesi 10cm (pa gure dhe e ngjeshur mire), kurse mbi te duhet te hidhet nje shtrese dheu (30÷40)cm. Tubacionet metalik te sifoneve, para se te vendosen ne kanal duhet te hidroizolohen me qellim qe te mbrohen nga ndryshku.
- Duke pasur prurjen (Q), gjatesine e sifonit (L) dhe diferencen e kuotave (ΔH), kontrollojme diametrin e sifonit (D), me anen e metodes se tentativave.
 - Duke pasur nje diameter te caktuar, bejme zbritjen e pareteve te tij dhe gjejme diametrin e brendeshem.
 - Gjejme rezen hidraulike (R) me ane te formules $R = \frac{S}{P}$ dhe


koeficientin shezi me ane te formules $C = \frac{1}{n} \cdot \sqrt{R}$, ku $n=0.013$ koeficienti i ashpersise se tubit te celikut.

- Percaktojme humbjet gjatesore me ane te formules $I = \frac{\Delta H - 0.1 \cdot \Delta H}{L}$.
- Percaktojme shpejtesine me ane te formules $V = C \cdot \sqrt{R \cdot I}$.
- Duke percaktuar S (siperfaqen e brendeshme), shpejtesine (V), percaktojme prurjen (Q) qe duhet te kaloje ne seksionin e marre me metoden e tentatives: $Q_{log} = S \cdot V$
- Nqs $Q_{log} < Q_{dhene}$ atehere duhet rritur diametri.
- Nqs $Q_{log} < Q_{dhene}$ atehere diametrin e percaktuar me anen e tentativave e permbush funksionin e kerkuar.



6.4 – Horografia e kanalit






Pjesa qe Mbulon Ky kanal eshte 100 ha dhe eshte shenuar ne harte

Relacioni Teknik per Projekt Zbatimin „Rehabilitimi i Kanalit Ujites Valikardhe , Zerqan , Bashkia Bulqize



Relacioni Teknik per Projekt Zbatimin „Rehabilitimi i Kanalit Ujites Valikardhe , Zerqan , Bashkia Bulqize



7.- AZHORNIMI ME INFRASTRUKTUREN EKZISTUESE

Ne territorin ku do te kryhen punimet, infrastruktura ekzistuese eshte si me poshte:

- Nuk ka rrjet inxhinjerek ujesjellesi, K.U.Z. TL dhe telefonie.
- Ne rastin kur kanali intersekon rrugen do te ndertohen nenkalime me tub çeliku ose per kalime kembesore kanali do te jete i mbuluar me soletone sipas projekteve te dhena.

8.- MBI ORGANIZIMIN E PUNIMEVE

8.1 – Organizimi i punimeve

Për objektin ”Rehabilitimi i kanalit vaditës te Turanit në rrethin e Tepelenes” është parashikuar që:

Për kanalën e veprat e artit:

- Të gjitha betonët janë parashikuar të derdhen në betonforma
- Nuk do te hidhet beton pa përdorur vibratorin
- Gjatë veshjes së kanalit është theksuar kujdesi që duhet treguar në zbatimin e fugës, si element shumë i rëndësishëm i konstruksionit të kanalit. Respektimi i detajit të saj kërkon shumë rigorozitet në

zbatim.

- Gërmimet për kanalën në projekt, janë parashikuar të kryhen me krahë.
- Për ndërtimin e kanalit është kërkuar dhe specifikuar përdorimi i materialeve të cilësisë së lartë sipas standarteve të vendit dhe ndërkombëtare dhe zbatimi me rigorozitet të kushteve teknike të zbatimit të punimeve.

Për tubacionet e polietilenit:

- Gërmimet për vendosjen e tubacionit në projekt, janë parashikuar të kryhen me krahë.
- Vendosja e rërës nën e mbi tub kërkohej që të bëhet me kujdes që të krijohet një shtresë rrafshuese dhe e butë për tubin. Kjo mbushje si proces delikat do të kryhet me krahë.
- Futja e tubit në kanal bëhet me shumë kujdes për të mos e dëmtuar atë.
- Prova e tubit bëhet sipas kushteve teknike dhe vetëm pas kryerjes së provës tubi futet me kujdes në kanal.

Materialet për ndërtimin e objektit janë parashikuar të sigurohen si më poshtë:

- Inertët do të merren në distancën 10km.
- Çimento, hekuri, etj. janë parashikuar të merren në distancën 10km.

- Tubat e çelikut dhe tubat e polietilenit janë parashikuar të merren në distancën prej 70km.
- Betonet janë parashikuar të jenë të markës C 16/20.

Persa i takon rrugëve te hyrjes në objekt do të shfrytëzohen rruga ekzistuese paralele me objektin si dhe rruget ekzistuese pyjore. Kontraktori mund të hapë edhe ndonje segment rrugë shtese për të krijuar stacione të furnizimit me materiale jo më larg se 500 metra

Eshtë patur parasysh zbatimi me rigorozitet i kushteve teknike të zbatimit të punimeve për punimet me tubacione polietileni si dhe kushtet teknike për provat me ngarkesë të tubacioneve prej çeliku.

Për të gjithë zërart e punimeve, do të zbatohen me rigorozitet kushtet teknike të zbatimit të punimeve, duke përdorur materiale që plotësojnë standartet në fuqi, të cilat jepen në listën e normave e standarteve që shoqërojnë projektin.

8.2 – Preventivi i punimeve

Sipas preventivit punimet per realizimin e objektit sipas projektit te parashikuar kushtojne 23 284 317 lek pa tvsh

Mbi bazën e matjeve topografike të kryera në terren janë hartuar profilat gjatësor mbi bazën e të cilëve janë llogarritur volumet e punimeve, për të cilat është hartuar preventivi i plotë i objekteve në veçanti dhe i cili përfshin të gjitha zërat e punës të parashikuara në projekt-zbatim. Po

kështu janë llogarritur volumet e punimeve për ndërtimin e veprave të artit, vendosjen e tubit të çelikut, tubit polietilen, etj.

Vlefata e tij totale pa T.V.SH. prej **23 284 317 leke** ka dalë mbi bazën e çmimeve të tregut sipas vkm nr. 629 dt 15.07.2015 për materialet e ndryshme që do të përdoren dhe për çdo zë punimi janë hartuar analizat e çmimeve të cilat janë të ndara në katër strukturat e tyre kryesore; puntori/mbi-puntori, material, transport, makineri.

Normat e harxhimit të materialeve dhe të fuqisë punëtore janë marrë nga manuali aktual i punimeve të ndërtimit si dhe të ligjeve për koston dhe tatim taksat që janë në fuqi aktualisht.

Në to janë përfshirë shpenzimet plotësuese 10% dhe fitimi 8%. Preventivi gjithashtu është hartuar me të gjithë zërat e punës dhe me strukturat përkatëse TVSH 20%) sipas VKM e të ligjeve në fuqi. Strukturat e çmimeve të nxjerra nga projektuesi bazohen në çmimet aktuale të tregut të vendit tonë.

Preventivi përfshin volumet e punimeve dhe analizat e ndryshme për disa lloj strukturash.

Volumet e paraqitura në tabelën e volumeve janë volume të vlerësuar të punimeve dhe do të rimaten në thellësi të punimeve.

Punimet e përhershme do të maten me përmasat thellësimtare të objektit apo të strukturës përveçse kur përshkruhet ose parashkruhet në ndryshe në kontratë.

Çmimet njësi për tabelën e volumeve, përveç kur parashikohet ndryshe në kontratë, do të mbulojnë gjithë detyrimet e kontraktuesit lidhur me

proceset e nevojshme te punes qe jane te nevojshme per realizimin e nje strukture apo per mirembajtjen e saj konform kushteve te projektit dhe specifikimeve teknike.

Konkuruesi me zerat e punes qe jane perfshire ne tabelen e volumeve (preventiv) do te realizoje plotesisht projektin e dhene prandaj Konkuresi kur vendos cmimet per njesi duhet ta kete parasysh kete fakt.

- Punime ne ekonomi (dite pune)

Seksioni i punimeve ne ekonomi te tabelës së volumeve perfshin rastet kur punimet urdherohen te kryhen me baze ditepune .

9.- MBI AFATET E KRYERJES SE PUNIMEVE

Nga ana e projektit mbi bazen e volumeve te parashikuara ne preventiv u krye zberthimi total per fuqine punetore, makinerine, materialet dhe transportin ne objekt.

Ky zberthim jepet ne nje flete te bashkelidhur projektit dhe mbi bazen e tij dalin nevojat per punetori, transport dhe makineri ne ndertimin e ketij objekti.

Keshtu mbi bazen e zberthimit te oreve te punes te fuqise punetore del e nevojshme qe nga ana e kontraktorit te punesohen ne kete objekt 32 punetore per nje afat prej 4.5-5 muaj.

Gjithashtu kontraktori i punimeve duhet te kete ne objekt ne nje periudhe 3,5 mujore nje automjet vetshkarkues minimumi 5 ton per

kryerjen e transportit te materialeve te ndryshme te nevojshme per ndertimin e tij.

Pervec mjeteve te transportit duhet te parashikohet qe ne objekt te perdoren dy motobetoniera te levizshme 250l, kater vibratore per nje periudhe 3,5 mujore. Gjithashtu duhet te parashikohet marrja e nje elektropompe per nje periudhe 1 mujore. Po keshtu eshte e domosdoshme te parashikohet nje motosaldatrice per nje periudhe kohe prej 2 muaj.

Nga sa permendem me siper rezulton se afati optimal per perfundimin e punimeve te ndertimit te ketij objekti eshte 4,5-5 muaj (kalendarik).

- MANUALI I INSTRUKSIONEVE DHE REKOMANDIMEVE TE MIREMBAJTJES

Per te bere te mundur funksionimin normal te ketij objekti projekti rendit keto instruksione per mirembajtje te vazhdueshme per periudha te ndryshme :

PARA FILLIMIT TE SEZONIT TE UJITJES

1- Kanalet e hapur te jene te pastruar nga materialet e ngurta qe mund te depozitohen gjate sezonit te dimrit.

2- Te sigurohemi ne se prizat jane funksionale duke bere manovrimin e portave metalike.

3- Te kontrollohen pusetat e komandimit ne sifonat duke bere mbylljen e saracineskave ne te gjithë pusetat.

4- Po ashtu te hapen portat metalike ne hyrje dhe dalje te sifonave.

PAS SEZONIT TE UJITJES

1- Te hapen saracineskat e shkarkimit ne pusetat e komandimit te sifonave dhe te behet grasatimi I tyre.

2- Te behet mbyllja e portave metalike ne hyrje dhe dalje te sifonave.

3- Te hapen portat metalike te te gjithë prizave neper rrjetin shperndares te kanaleve